

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Së bashku me Raportin e Audituesit Ligjor

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	3
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	8
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE	12
3. ZBATIMI I STANDARTEVE TË REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR	14
4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL	15
6. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE	26
7. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE	29
8. AKTIVET NË PËRDORIM	31
9. AKTIVE TË TJERA FINANCIARE	32
10. AKTIVE FINANCIARE, INVESTIM NË PJESËMARRJE	32
11. INVENTARI	32
11. INVENTARI (VAZHDIM)	33
12. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE NETO DHE ME GRUPIN	33
13. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA NETO	36
14. MJETET MONETARE NË ARKË E NË BANKË	37
15. MJETET MONETARE TË NGURTËSUARA	37
16. KAPITALI	38
17. HUATË	38
20. DETYRIME PËR TAKSA DHE SIGURIME SHOQËRORE	41
21. DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA	42
22. DETYRIME PËR TATIM FITIMIN	42
23. PROVIZIONET	43
24. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT	43
25. TË ARDHURA TË TJERA	43
26. ENERGJIA E BLERË	44
27. TARIFA TRANSMETIMI	44
28. LËNDA E PARË, MATERIALE KONSUMI TË PËRDORURA	44
29. SHPENZIME PERSONELI	45
30. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI	45
31. SHPENZIME TË TJERA	46
32. SHPENZIME FINANCIARE NETO	46
33. TATIMI MBI FITIMIN	47
34. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA	47
35. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR	49
36. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA	53
37. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	53

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Drejtimit dhe Aksionarit të Shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" Sha

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionit me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" Sha (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, duke përjashtuar efektet e mundshme të çështjeve së përkrahura në seksionin e raportit tonë "Baza e Opinionit me rezervë", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza e Opinionit me Rezervë

1. Siç është paraqitur në shënimin 6 dhe 7 të pasqyrave financiare "Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale" janë në vlerën 63,768,939 mijë Lek (31 dhjetor 2020 : 56,027,929 mijë Lek). Shoqëria ka përfunduar inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale dhe ka finalizuar regjistrin e aktiveve të qendrueshme të trupezuara, por nuk ka mundur akoma të marrë titujt e pronësisë (aktet e pronësisë) për pasuritë e paluajtshme që ka në përdorim. Bazuar në procedurat e auditimit, ne nuk arritëm të merrnim sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur mbi ekzistencën, plotësinë dhe të drejtën e pronësisë të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm për aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020. Gjithashtu Shoqëria nuk ka njohur tatimin mundshëm të shtyrë që lind si pasojë e diferencave të përkohëshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata dhe bazës tatimore, sipas kërkesave të Standartit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 12 Tatimi mbi të ardhurat. Bazuar në informacionin që kemi marrë, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që do të rezultojnë nga njohja e tatimit të shtyrë në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.
2. Siç është paraqitur në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2021, hua afatshkurtër dhe hua afatgjata paraqiten në vlerën 19,363,523 mijë Lek (31 dhjetor 2020 : 16,810,438 mijë Lek). Shoqëria nuk ka kryer njohjen me vlerën e drejte në ditën e parë të marrjes së huave sikurse kërkohet nga SNRF 9 Instrumentat Financiare. Gjithashtu, Shoqëria ka zgjedhur të përdorë metodën e njohjes së huave në datën e mbylljes së pasqyrave financiare me vlerën e tyre të drejtë. Huatë e marra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë paraqitur me vlerën kontabël e cila në gjykimin e drejtimit të grupit është përafërsisht sa vlera e drejtë e tyre në atë datë. Megjithatë, ne nuk jemi në gjendje të fitojmë siguri të arsyeshme që vlerat e huave paraqitur në pasqyrat financiare të veçanta të mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përfaqësojnë vlerën e tyre të drejtë. Si rrjedhojë, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë rregullim i mundshëm do të kishte në pasqyrat financiare më datën dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare më dhe për vitin që mbyllen me 31 dhjetor 2020 janë audituar nga auditues të tjerë të cilët në datë 29 dhjetor 2023 kanë shprehur një opinion të modifikuar në lidhje me këto pasqyra.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për të dhëna të tjera. Të dhënat e tjera konsistojnë në të dhëna të përfshira në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi, në përputhje me Nenin 17 dh 19 të Ligjit nr. 25/2018 "Të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare", i ndryshuar, por nuk përfshin Pasqyrat Financiare dhe Raportin tonë të Auditimit. Raporti vjetor pritet të jetë i disponueshëm për ne, pas datës së këtij Raporti të Audituesit të Pavarur. Opinioni jonë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon të dhëna të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë opinionimi mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë të dhënat e tjera të identifikuar më lart, kur këto të dhëna të jenë të disponueshme dhe, duke e bërë këtë, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është material në kundërshtim me pasqyrat financiare apo njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose në të kundërt nëse është material. Gjatë rishikimit të raportit vjetor, nëse konstatojmë se ekziston një gabim material në të, nga ne kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne, gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Kreston Albania Sh.p.k.
Rruga Muhamet Gjollësja, shk. B, K. 6, Ap. B-6
Pranë Qendrës Tregtare Ring Tirane Shqipëri, 1001
Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm L420070121

Rezar LLUKAÇEJ
Auditues Ligjor
Partner Angazhimi



Gerta Avrami
Auditues Ligjor
Partner Angazhimi



Tiranë, më 10 Korrik 2024

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a

Pasqyra e Pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumatat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktivitet afatgjatë			
Aktivitet afatgjatë materiale	6	63,204,298	55,636,241
Aktivitet afatgjatë jomateriale	7	564,641	391,688
E drejtë përdorimi	8	611,882	162,531
Aktivitet të tjera financiare	9	-	-
Aktivitet financiare investim në pjesëmarrje	10	-	-
Totali i aktiveve afatgjatë		64,380,821	56,190,461
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	11	5,406,140	4,616,906
Llogari të arkëtueshme tregtare neto	12	432,103	441,734
Llogari të arkëtueshme tregtare neto Grupi	12a	5,734,714	3,526,270
Llogari të arkëtueshme të tjera neto	13	384,939	1,005,579
Llogari të arkëtueshme të tjera neto pale lidhur	13a	-	3,292,412
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	13	-	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	14	1,029	14,990
Mjetet monetare të ngurtësuar	15	9,503	9,800
Totali i aktiveve afatshkurtra		11,968,428	12,907,691
Totali i aktiveve		76,349,249	69,098,151
KAPITALI			
Kapitali aksionar/themeltar		3,500	3,500
Rezerva rihvlerësimi aktive të qëndrueshme trupezuara		22,610,075	24,277,575
Rezerva të tjera		1,828,166	1,828,166
Humbje e akumuluar		(40,079,080)	(39,379,475)
Rezultati i i ushtrimit		(3,676,575)	(2,367,105)
Totali i kapitalit	16	(19,313,914)	(15,637,339)
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	17	8,939,182	9,643,105
Detyrime për qira financiare	18	332,965	56,643
Totali i detyrimeve afatgjatë		9,272,146	9,699,749
Detyrime afatshkurtra			
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	17	7,261,695	6,626,702
Hua afatshkurtra	17	3,162,646	540,630
Detyrime për qira financiare afatshkurtra	18	294,795	107,486
Llogari të pagueshme tregtare	19	7,903,663	203,985
Llogari të pagueshme tregtare grupi	19a	62,941,907	65,022,115
Detyrime për taksa dhe sigurime shoqërore	20	285,631	183,732
Detyrime të tjera afatshkurtra	21	933,022	358,937
Detyrime të tjera afatshkurtra Grupi	21a	2,090,165	1,264,126
Detyrime për tatim fitimin	22	621,572	571,200
Provizione	23	895,921	156,828
Totali i detyrimeve afatshkurtra		86,391,016	75,035,742
Totali i detyrimeve		95,663,163	84,735,490
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		76,349,249	69,098,151

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a

Pasqyra e Fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	24	28,368,094	26,297,281
Të ardhura të tjera	25	3,229	648,505
Total të ardhura		28,371,323	26,945,786
Energjia e blerë	26	(14,963,675)	(11,591,560)
Tarifa Transmetimi	27	(1,039,818)	(896,037)
Lëndë e parë e materiale konsumi të përdorura	28	(559,971)	(695,413)
Shpenzime personeli	29	(4,724,665)	(4,690,094)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	30	(3,717,228)	(3,367,345)
Shpenzime të tjera	31	(6,680,263)	(7,413,868)
Total shpenzime		(31,685,620)	(28,654,317)
Shpenzime financiare	32	(662,327)	(272,378)
Të ardhura financiare	32	570,420	185,004
Shpenzimet financiare neto		(91,907)	(87,374)
Fitimi/humbja para tatimit		(3,406,204)	(1,795,905)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	33	(270,372)	(571,200)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(270,372)	(571,200)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(3,676,575)	(2,367,105)

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare .

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a

Pasqyra e Fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumatat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi/humbja e vitit	(3,676,575)	(2,367,105)
Fitimi/humbja per:	-	-
Pronaret e njesise ekonomike meme	-	-
Interesat jo-kontrolluese	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	1,667,500	1,698,742
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	1,667,500	1,698,742
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	(2,009,076)	(668,363)

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare .

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a

Pasqyrat e Flukseve të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(3,406,204)	(1,795,905)
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Axhustime	-	-
Axhustim për tatim fitimi	(270,372)	(571,200)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	3,717,228	3,367,345
Të ardhura nga interesi	(6)	0
Shpenzime interesi dhe pagesa për garanci bankare	224,966	144,701
Shpenzim/(rimarrje) për zhvlerësimin e inventarit	9,796	(8,185)
Rimarrje e zhvlerësimit për të arkëtueshmet nga klientët	387,655	58,656
Shpenzime për provizione	895,920	156,828
Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në bilancin e huamarrjeve të mbajtura në monedha të huaja	(189,392)	(95,975)
<i>Ndryshimi në kapitalin garkullues</i>		
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme tregtrare	(2,586,467)	(4,026,660)
Rënie/(rritje) në inventar	(799,029)	963,814
Rënie/(rritje) në aktive të tjera	3,913,052	(3,208,179)
Rënie/(rritje) në Llogari të ngurtësuar	297	(9,800)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	5,619,469	6,614,611
Rritje/(rënie) në detyrimet për taksat dhe sigurime shoqërore	152,271	754,902
Rritje/(rënie) në detyrime të tjera	1,463,338	1,385,226
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	9,132,521	3,730,180
Tatim fitimi paguar	(220,000)	-
Interesi i paguar	(211,865)	(139,027)
Pagesa për garancitë	(13,102)	(5,674)
Interesi i arkëtuar	-	-
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(10,882,024)	(3,955,316)
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale	(243,479)	(159,486)
Aktive financiare (ambjente me qira)	(782,127)	(287,497)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(11,907,629)	(4,402,298)
Aktivitetet financuese		
<i>Ritja ne rezerven e rivlerësimit</i>	-	-
Arketime nga hua te marra	-	-
Pagesa per hua	2,829,406	626,423
Arketim per qira financiare	505,806	239,022
Pagesa per qira financiare	(318,496)	(131,536)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	3,016,715	733,908
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(13,961)	13,064
Mjetet monetare në fillim të periudhës	14,990	1,926
Efektet e kursit të këmbimit mbi balancën e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre të mbajtura në monedhë të huaj	189,392	95,975
Mjetet monetare në fund të periudhës	1,028	14,990

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a

Pasqyrat e Lëvizjes së Kapitaleve të Veta për vitin e mbylur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumatat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Pozicioni financiar më 1 janar 2020	Kapitali aksionar	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva të tjera	Humbja e akumuluar	Totali
	3,500	-	-	(6,990)	(3,490)
Vendim Asambleje	-	1,010,837	1,828,166	(25,191,769)	(22,352,766)
Rezerve rivlerësimi aktivesh	-	24,965,479	-	(15,879,458)	9,086,022
Rezerve rivlerësimi aktivesh amortizimi i vitit 2020	-	(1,698,742)	-	1,698,742	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	-	(2,367,105)	(2,367,105)
Totali i të ardhurave 2020	-	-	-	(2,367,105)	(2,367,105)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	3,500	24,277,575	1,828,166	(41,746,580)	(15,637,339)
Vendim Asambleje	-	-	-	-	-
Rezerve rivlerësimi aktivesh	-	-	-	-	-
Rezerve rivlerësimi aktivesh amortizimi i vitit 2021	-	(1,667,500)	-	1,667,500	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave 2021	-	-	-	(3,676,575)	(3,676,575)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	3,500	22,610,075	1,828,166	(43,755,655)	(19,313,915)

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare..

Pasqyrat Financiare të vitit 2021, së bashku me shënimet u aprovuan nga manaxhimi në datë 10.12.2024 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Blendian Dalipi

Administratori OSSH sh.a



Redvin Marku

Drejtor Departamenti Ekonomik OSSHEE GROUP sh.a

"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a (ose "Shoqëria") ka objekt kryesor të aktivitetit shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të matjes së energjisë elektrike etj, si dhe cdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë. Shoqëria është krijuar më datë 28 Mars 2018 si shoqëri e kontrolluar nga Shoqëria mëmë - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ShA (OSHEE). Shoqëria është regjistruar në QKB më datë 30 Mars 2018.

Shoqëria u krijua në zbatim të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", me qëllim ndarjen e aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit për klientët e tregut të rregulluar, nga aktiviteti i shpërndarjes dhe aktiviteti i shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike. Për këtë, bazuar në vendimin e Asamblesë së OSHEE ShA nr.458 dt.15.2.2017 "Për aprovimin e modelit të korporatës", Ministri i MIE, me urdhërin nr.157 dt.12.2.2018, urdhëroi krijimin e tre shoqërive, ndër ta, krijimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. Me vendimin nr.216 dt.11.10.2018, ERE vendosi transferimin e licencës së Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të OSHEE tek OSSH. Por me vendimin nr.211 dt.18.12.2019, ERE vendosi që periudha tranzitore të shtyhet deri me 31.12.2019. Aksionari i shoqërisë, me vendimin e datës 24.12.2019, vendosi që shoqëria të kryejë të gjitha veprimet/ operacionet si subjekt i veçantë nga strukturat e OSHEE SHA. Kështu, nga data 1.01.2020, Shoqëria ka ushtruar normalisht aktivitetin me të gjitha të drejtat operacionale dhe kontraktore si subjekt juridik, sipas licensimit dhe akteve ligjore në fuqi.

Kapital themetar i shoqërisë është në vlerën 3.5 mln lekë i ndarë në 3,500 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1,000 lekë secila, të cilat zotërohen 100% nga Shoqëria Mëmë. Funksionet e përfaqësuesit të aksionerit për shoqërinë ushtrohen nga Administratori i OSHEE SHA. Sistemi i administrimit të shoqërisë është me një nivel. Administrator nga data 31.12.2019 e deri 22.09.2022 ka qene z.Petra Lika, nga data 23.09.2022 deri ne daten 27.10.2022 nga Z. Dhimiter Kote dhe nga data 28.10.2022 eshte z. Blendian Dalipi

Këshilli i administrimit është i përbërë nga tre persona dhe drejtohej nga Kryetari z.Përparim Nebiaj nga data 20.12.2019 deri 11.07.2023 , nga Znj Rudina Banushi nga data 11.07.2023 deri ne daten 30.10.2023 dhe nga data 30.10.2023 Keshilli i Administrimit drejtohet nga Z Erald Hasanaj.

Shoqëria e ka vendndodhjen në Shqipëri. Adresa kryesore e shoqërisë është në : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88,H.1, Kati V, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë (adresa e regjistruar në QKR).

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 numri mesatar i punonjësve sipas kategorive është 5,332 (2020: 5,240 punonjës).

Në zbatim të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", me qëllim ndarjen e aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit për klientët e tregut të rregulluar, nga aktiviteti i shpërndarjes dhe aktiviteti i shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike, bazuar në vendimin e Asamblesë së OSHEE-GROUP ShA nr.458 dt.15.2.2017 "Për aprovimin e modelit të korporatës", Ministri i MIE, me urdhërin nr.157 dt.12.2.2018, urdhëroi krijimin e tre shoqërive aksionere, me ofertë private, me kapital themeltar nga 3,500 mijë lekë financuar nga OSHEE-GROUP ShA.

Shoqëritë të kontrolluara nga OSHEE-GROUP ShA janë :

- Shoqëria : Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL SHA), me objekt veprimtarie blerjen dhe menaxhimin e energjisë dhe operimin në tregun e lirë
- Shoqëria : Furnizimi i Shërbimit Universal (FSHU SHA), me objekt veprimtarie furnizimin me energji elektrike të klientëve të rregulluar si dhe sigurinë e cilësisë tregtare të shërbimit ;
- Shoqëria : Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Group (OSHEE-GROUP SHA), me objekt veprimtarie shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes për sigurimin e energjisë elektrike klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM)

Ministri i MIE, me urdhrin nr 157, datë 12.02.2018, në përputhje me ligjin nr 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" me qëllim ndarjen e aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit për klientët e tregut të rregulluar, nga aktiviteti i shpërndarjes dhe aktiviteti i shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike, urdhëroi krijimin e tre shoqërive aksionare, me ofertë private, me kapital themeltar nga 3,500 mij lek financuar nga OSHEE- GROUP sh.a

Në kushtet kur:

- Urdhri i MIE, (në cilësinë e pronarit të kompanisë" përcakton që OSHEE sh.a do të vazhdojë të ekzistojë si shoqëri si dhe do të jetë shoqëria mëmë për 3 shoqëritë bija,
- Shoqërite bija ishin themeluar si entitete juridike të vecanta më parë sa të vendosej fillimi i procesit të ndarjes,
- Neni 227 i ligjit nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, datë 14.04.2008 pika 4, c : Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:
 - Vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe cregjistrimin e saj nga QKR, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për QKR" pa kryerjen e likuidimit.
 - u përcaktua si model për ndarjen të jetë ndarja e shoqërisë OSHEE sh.a ndërmjet transferimit të aktivitetit, aktiveve, detyrimeve dhe kapitaleve të veta nga OSHEE sh.a për të tre shoqëritë e reja FSHU sha, OSSH sha dhe FTL sha dhe jo një model klasik i ndarjes shoqërive vetëm mbi bazën e ndarjes së aktiveve dhe detyrimeve mbi bazën e bilancit kontabël.

Nisur nga përcaktimi i ligjit dhe objekti i aktivitetit të së cilës shoqëri Drejtimi i shoqërisë OSHEE sha ka përcaktuar 2 kriteret kryesore për ndarjen:

- Për ndarjen e aktivitetit të shoqërisë si kriter të ndarjes ka përcaktuar kriterin e funksionit të aktiveve të shoqërisë OSHEE sha në raport me objektin e aktivitetit të secilës shoqëri. Kjo do të thotë se aktiviteti i shoqërisë OSHEE sha do të transferohen shoqërisë përkatëse në funksion të aktivitetit të së cilës janë.
- Për ndarjen e kapitalit themeltar, kapitaleve të veta dhe detyrimeve është përdorur kriteri i ndarjes së kapitaleve të veta mbi bazën përqindjes së vlerës neto të aktiveve të çdo shoqërie të ndarë në raport me aktivin neto të shoqërisë OSHEE sha para ndarjes.

Në përmblendhje të tre marrveshjeve të ndarjes Pasqyrat financiare në 31 dhjetor 2019 të OSHEE sha sipas kriterëve të mësipërme paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Rezerva rivlerësimi	1,010,837
Rezerva të tjera	1,828,166
Humbje e akumuluar	(22,581,185)
Rezultati i ushtrimit	(2,610,584)
	(22,352,766)

Deri në momentin e hartimit të raportit të ndarjes janë likuiduar dhe mbyllur rreth 18,7 miliard lek detyrime afatshkurtra të cilat në këtë datë nuk ekzistojnë në marrveshjen e lidhur mes palëve. këto detyrime janë zëvendësuar me kërkesa dhe detyrime të ndërsjellta.

	31 dhjetor 2019
Detyrime ndaj OSHEE (Hua afatgjate KESH, IBDR)	10,137,199
Detyrime ndaj OSHEE (Pjesa afatshkurter e huase afatgjate KESH, IBDR)	6,103,460
Detyrime ndaj OSHEE (Llogari të pagueshme tregtare KESH)	27,743,260
Detyrime ndaj OSHEE (Llogari të pagueshme tregtare OST)	7,147,411
	51,131,330

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM)

Në mënyrë më të detajuar ndarja e furnitoreve KESH sha dhe OST sha paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Furnitor energjie prodhim vendas	26,644,409
Diference rivileresimi KESH	(100,697)
Furnitor investimi blerje AQT KESH	1,188,638
Blerje energjie (import)	10,909
	27,743,260

	31 dhjetor 2019
Furnitor transmissiioni energjie (OST)	7,111,283
Diference rivileresimi OST	(4,338)
Furnitor disbalance energjie	40,466
	7,147,411

Edhe transferimi i një pjese të furnitorëve të krijuar para 31.12.2019 edhe të palikujduar deri në datën e hartimit të marrveshjeve në pasqyrat finale janë lënë si kërkesa dhe detyrime të ndërsjellta, kjo pasi situata e pagesave të tyre është dinamike dhe pjesa me e madhe e tyre pritet të likujdohet deri në mbyllje të vitit, por edhe transferimi i tyre paraqiste vështirësi në regjistrimet kontabël.

	31 dhjetor 2019
Hua afatshkurtra	5,064,941
Llogari të pagueshme tregtare	9,173,757
Detyrime për taksa dhe sigurime shoqerore	2,205,056
Detyrime të tjera afatshkurtra	2,426,028
Detyrime për tatim fitimin	1,412,772
Provizione	3,670,716
	23,953,269

Në lidhje me huatë afatgjata në marrveshjet e lidhura midis shoqërive për shkak të problemeve ligjore që mbart transferimi i tyre nga OSHEE për të tre shoqëritë pritëse, këto detyrime në këtë fazë janë lënë te shoqëria OSHEE sha.

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a

Shënime shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM)

Ndarja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale në mënyrë analitike për secilin nga grupet e aktiveve është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Toka	1,064,968
Permiresimi i Tokes	369,108
Ndertesa dhe konstruksione	4,236,353
Makineri dhe pajisje	46,773,142
Mjete transporti	367,846
Pajisje zyre	162,101
Pajisje IT	1,323,874
AAGJ-M ne process	10,416,387
Amortizimi akumuluar Tokave	(105,067)
Amortizimi akumuluar Ndertesa dhe konstruksione	(486,519)
Amortizimi akumuluar Makineri dhe pajisje	(16,060,794)
Amortizimi akumuluar Mjete transporti	(254,427)
Amortizimi akumuluar Pajisje zyre	(93,607)
Amortizimi akumuluar Pajisje IT	(977,754)
	46,735,610

	31 dhjetor 2019
Të tjera AAGJ-JM	58,679
Softëare	497,730
AAGJ-JM ne proces	51,932
Amortizim Akumuluar AQT	(52,641)
Amortizim Akumuluar Softëare	(218,758)
	336,942

Në muajin janar 2020, duke qenë se OSHEE sha ishte në proces inventarizimi ndarja e tyre u krye mbi bazën e të dhënave të kontabilitetit (regjistrave të AQT-ve) gjendje në 31.12.2019.

Në lidhje me inventarët, Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë OSHEE mori vendimin qarkullues nr 4, datë 21.01.2020, mbi bazën e të cilit Asambleja e Përgjithshme e Aksionerit mori vendimin nr 1192/1, datë 10.02.2020, dhe nga ana e OSHEE sha ka dalë urdhri nr 4118, datë 23.04.2020 për ngritjen e grupit të punës për kalimin e vlerave inventariale në llogaritë e tre kompanive të reja. Ndarja e materialeve u bazua në konsumin faktik që secila shoqëri do të ketë nevoja nga data 1.01.2020 deri në përfundimin e procesit të transferimit.

	31 dhjetor 2019
Nafta, mat. djegshem	18,320
Materiale konsumi	6,007,399
Renje vlere inventar	(453,185)
Diferenca inventariale	2
	5,572,536

Operatori i Sistemit të Shperndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM)

Miratimi i kalimit të llogarive të arkëtueshme tregtare është bërë nga Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE Group sh.a me vendimin nr 7 datë 09.03.2020.

	31 dhjetor 2019
Kliente lidhje e re	6,883
Kliente aktivitete te ndryshme	666
Debitor te tjere joenergjie	178
Shpenzime të parapaguara	79,018
	86,745

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në përputhje me dhe ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në Shqipëri.

2.2 Baza e matjeve

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar. Referohuni Shënimit 5.1 për pasiguri në lidhje me ngjarjet dhe kushte që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në bazë të parimit të vijimësisë.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.4. Monedha raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha informacionet financiare janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur deklarohet ndryshe.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare individuale kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5.1. Jeta e dobishme e aktiveve

Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me AQT të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë e industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore.

Ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak se përfshin supozime mbi zhvillimet teknologjike, në një degë shumë inovative si telekomunikacioni. Për më tepër për shkak të peshës së konsiderueshme të aktiveve afatgjata në totalin e aktiveve, këto supozime mund të jenë materiale në pozicionin aktual financiar të shoqërisë dhe në rezultatin e operacioneve të shoqërisë.

2.5.2. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit me qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

2.5.3. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, Shoqëria identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje të një aktivi financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kriterëve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5.4. Provizione për çështje gjyqësore

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Në mënyrë që të përcaktohet probabiliteti i një rezultati të ardhshëm, shoqëria përdor këshillues ligjor të brendshëm dhe të jashtëm.

3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Janë efektive në periudhën raportuese, ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), megjithëse miratimi i tyre nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të shoqërisë:

- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare", efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023 ;
- Ndryshimet në SNK 8 "Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet", efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023 ;
- Ndryshimet në SNK 37 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara" efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 ;
- Ndryshimet në SNRF 1 "Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve" efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 ;
- Ndryshimet në SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por ende jo efektive, ndryshime në Standardet ekzistuese dhe Interpretime janë publikuar nga BSNK.

Ende nuk janë efektive në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet e tyre, të cilat shoqëria ka zgjedhur të mos i adoptojë pasi parashikon se nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre :

- Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2021, datë efektive e modifikuar më pas në 1 janar 2023).
- Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 SNRF: Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023);
- Ndryshimet në SNK 8: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (lëshuar më 12 shkurt 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023)
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12 (publikuar më 7 maj 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).
- Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë: Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe kthim me qira (lëshuar më 22 shtator 2022 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024);

3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar (vazhdim)

- Klasifikimi i detyrimeve si korrente ose afatgjata – Ndryshime në SNK 1 (fillimisht i lëshuar më 23 janar 2020 dhe i ndryshuar më pas më 15 korrik 2020 dhe 31 tetor 2022, përfundimisht në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2024).

Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më herët Shoqëria. Menaxhimi parashikon që të gjitha deklaratimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë duke filluar nga ose pas datës efektive të shpalljes. Standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet e pa miratuara në vitin aktual nuk janë përfshirë në shënimet shpjeguese pasi ato nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Drejtimi i ka bërë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e raportimit të pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve. Shpjegimi i supozimeve kyçe është përfshirë në seksionet përkatëse të shënimeve, aty ku janë përshkruar vlerësimet domethënëse.

4.1. Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së pasqyrës së pozicionit financiar janë rivekur në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit emërtuara në monedhë të huaj në datën e hartimit të së pasqyrës së pozicionit financiar janë si më poshtë (në Lek):

<u>Monedha</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
1 EUR	120.76	123.7
1 USD	106.54	100.84
1 GBP	143.95	137.93
1 KRW	0.0894	0.0927
1 JPY	92.57	97.88
1 SDR	149.11	145.24

Me përjashtim të ndonjë efekti që mund të rrjedhë nga ndryshimet në politikat kontabël të përshkruar në shënimin 2.4 të këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.2. Instrumentat Financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH. Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet e financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivitet financiarë – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parësë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktiviteti financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktiviteti dhe nuk rievluhet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivitet financiarë – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktiviteti financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktiviteti financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivitetet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë të kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivitet financiarë - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivitetet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktiviteti financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktiviteti financiar ("aktiviteti fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aset në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paafetësisë së pagesës ose falimentimit. Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogarit, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.3 Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivët dhe pasivët financiarë kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe të shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

4.4 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.5 Inventari

Inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit përfshin shpenzimet e njohura gjatë blerjes së inventarit, prodhimit ose koston së tjetërsimit dhe kostove të tjera shtesë të njohura për ruajtjen dhe sjelljen në pozicionin ekzistues të inventarit. Në rastin e inventarit të prodhuar dhe prodhimit në proces koston përfshijnë një marzh të kostove shtesë prodhuese, bazuar në operimin me kapacitet normal. Vlera neto e realizueshme është ekuivalente me diferencën e cmimit të shitjes së parashikuar, në rastin e një veprimtarie normale të biznesit me koston totale të parashikuara dhe shpenzimet e shitjes.

4.6 Aktivët Afatgjatë Materiale

Aktivët janë transferuar nga Shoqëria mëmë Oshee Group sh.a dhe që prej datës 01.01.2016, aktivët afatgjatë materiale janë paraqitur në pasqyrën të pozicionit financiar me shumën e tyre të rivlerësuar që janë vlerat e drejta në datën e rivlerësimit duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Toka dhe ndërtesat, përfshijnë përgjithësisht nënstacione, kabinat elektrike dhe ndërtesa administrative për zyra.

Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë, përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër të lidhur direkt me transformimin e aktivit në kushte pune për qëllimin e tij të caktuar si dhe koston e çmontimit dhe largimit të aktivit dhe kthimin e zonës ku ka qenë vendosur aktivi në gjëndjen e mëparshme. Çdo blerje programesh kompjuterike që është pjesë e pandashme e veprimtarisë së pajisjes është kapitalizuar si pjesë e kësaj pajisjeje.

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të aktiveve afatgjatë materiale, njihet në vlerën e mbetur të saj, vetëm nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me këtë pjesë të zëvendësuar do të rrjedhin në Shoqëri si dhe nëse kostoja e saj mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Koston ditore të mirëmbajtjes dhe të tjera të lidhura me aktiveve afatgjatë materiale, do të njihen në shpenzimet e periudhës përkatëse që ato ndodhin. Kostoja e mirëmbajtjes, riparimit dhe zëvendësimit të njësive jo të rëndësishme të aktiveve afatgjatë materiale regjistrohet si shpenzim mirëmbajtjeje në periudhën kur ndodh. Rinovimet dhe përmirësimet kapitalizohen. Kur kryhet shitja, nxjerrja jashtë përdorimit ose zëvendësimi i një pjesë të aktiveve afatgjatë materiale, kostoja dhe zhvlerësimi i akumuluar përkatës i zërit të nxjerrë jashtë përdorimit ose pjesës së zëvendësuar eliminohen nga llogaritë. Fitimi ose humbja që mund të rezultojë regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave.

Ndërtimi në proces përfshin punën e kontraktuar nga palët e treta ose punën e gjeneruar për qëllime të brendshme për aktivet afatgjatë materiale ende të papërfunduara. Ky zë paraqet investimet e kryera (por ende të papërfunduara) në periudhën aktuale dhe/ose paraardhëse financiare. Pas përfundimit, këto aktive dhe shumat e lidhura me to të mbartura nën zërat e parapagimeve në avancë, ose ndërtimeve në proces, kapitalizohen si zëra të aktiveve afatgjatë materiale. Amortizimi vjetor paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë e industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore. Miratimi i jetës së dobishme u bë në datën 10.07.2023 nga Administratori. Ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak se përfshin supozime mbi zhvillimet teknologjike, në një degë shumë inovative si telekomunikacioni. Për më tepër për shkak të peshës së konsiderueshme të aktiveve afatgjatë në totalin e aktiveve, këto supozime mund të jenë materiale në pozicionin aktual financiar të shoqërisë dhe në rezultatin e operacioneve të shoqërisë.

Tabela e mëposhtme shfaq kohën e përdorimit të vlerësuar të aktiveve:

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.6 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Kategorizimi i aktiveve sipas klases së aktiveve
 të qëndrueshme të trupezuara

Jeta e dobishme

AL1310 - Software	10
AL1410 - Licence	10
AL2110 – Ndertese kabine dhe murature	20-50
AL2230 – celes, indikator, vegla pune dhe aparatura	9-30
AL2231 – transformator fuqi, rryme, tensioni	20-45
AL2232 – linje ajrore dhe kabllore e tensionit të mesem	35-50
AL2233 – linje ajrore dhe kabllore e tensionit të ulet	35-50
AL2240 – mates elektrik, induktiv hde kabina	10-25
AL2250 – pajisje dhe sistem monitorimi dhe sisteme të tjera, server	5-10
AL2251 – pajisje informatike	5
AL2260 – automjete	10
AL2910 – mobilje dhe pajisje	6-13
AL3110 - toke	n/a
AL3120 – permiresim toke	25

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.7 Aktivet Afatgjata Jomateriale

Aktivët afatgjatë jomateriale përfshijnë licencat dhe softet .

Njohja dhe Matja

Licencat dhe softet , të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirë duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.8 Zhvlerësimi (Rënia në vlerë)

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivet jomateriale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përllogaritet në çdo datë të bilancit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e mbartur e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivit apo një njësie që gjeneron flukse paraje është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit. Humbja nga zhvlerësimi anulohet nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe nëse kanë ndryshuar supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet deri në masën që vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar pasi të ishte zbritur zhvlerësimi dhe amortizimi, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

4.9 Aktive investuese – Qiratë financiare

Aktiv investues është aktiv i mbajtur për t'u dhënë me qira dhe/ose rivlerësim i kapitalit (përfshirë aktivet në ndërtim për qëllime të tilla), fillimisht maten me kosto, përfshirë kostot e transaksionit. Ato fillimisht njihen në pasqyrën të pozicionit financiar kur risqet dhe përfitimet e pronësisë transferohen në Shoqëri pavarësisht nëse titulli është transferuar apo jo. Fillimisht maten me kosto. Pas periudhës së njohjes, aktivet e investimit maten me modelin e koston. Zhvlerësimi i këtyre aktiveve të investimit llogaritet bazuar në vlerën e tyre të mbetur. Aktivet e investimeve të mbajtura nga një qiramarrës si një aktiv i përdorimit të drejtë maten fillimisht me koston në përputhje me SNRF 16.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019), përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësi merr të drejtën e përdorimit të një aktivit në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohej nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit.

Shoqëria ka njohur:

- aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, pasi nuk ka pasur raste kur aktivit është me vlerë të ulët; dhe
- amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

SNRF 16 mbart të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17, por që tek Shoqëria nuk ka impakt.

Matja fillestare

Matja fillestare e aktivit me të drejtë përdorimi

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit mat aktivin me të drejtë përdorimi me kosto. Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi do të përfshijë;

- a) shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë sic përshkruhet më poshtë;
- b) çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit minus çdo stimul qiraje të marre;
- c) çdo kosto fillestare të drejtëpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- d) dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për montimin dhe lëvizjen e aktivit bazë

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.9 Aktive investuese – Qiratë financiare

Matja fillestare e detyrimit të qirasë

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë skontohej duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi do të përdor normën rritëse të huamarrjes së Shoqërisë.

Matja e mëpasshme

Matja e mëpasshme e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Pas datës së fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat aktivin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e kostos.

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë bëhet si më poshtë:

- duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;
- duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e qirasë;
- duke rimatur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar çdo rivlerësim ose modifikim të qirasë.

4.10 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar (nëse është materiale) fluksat e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen por paraqiten në shënime kur janë të rëndësishme.

4.11 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë fluksi bruto i përfitimeve ekonomike gjatë periudhës aktuale dhe normale të aktivitetit të një njësie ekonomike kur ato flukse rezultojnë në rritje në kapital, përveç rritjeve të kontributeve nga pjesëmarrësit e kapitalit. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të konsideruar dhe pranuar si të arkëtueshme për shitjen e mallrave dhe shërbimeve gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë së kompanisë. Të ardhurat janë të njohura neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet, rimbursimet dhe zbritjet.

Shoqëria i njeh të ardhurat në bazë të faturave të lëshuara, kur shumat e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që njësi do të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike. Shumat e të ardhurave nuk mund të konsiderohen të matshme me besueshmëri, derisa të gjithë detyrimet e kushtëzuara që kanë të bëjnë me shitjen të jenë zgjidhur. Shoqëria bazon vlerësimet e saj mbi rezultatet historike, duke marrë parasysh llojin e konsumatorit, llojin e transaksionit dhe specifikat e çdo marrëveshjeje.

(a) Të ardhurat nga tarifat e shërbimitit të shpërndarjes dhe tarifes së mirëmbajtjes

Faturimet bëhen në baza mujore.

(b) Të ardhura të tjera

Të ardhurat mbi shërbimet e ofruara klientëve si p.sh. lidhje e re, ndryshimi i emrit në kontratë, verifikimi i matësit, etj. janë të njohura kur shërbimi ofrohet. Këto të ardhura, sëbashku me të ardhurat nga kamatëvonesat për pagesat me vonesë, janë të përfshira në të ardhura të tjera.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.11 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

(c) Të ardhurat dhe Shpenzimet Financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marrë parasysh metodën e interesit efektiv. Shpenzimet për interesa përfshijnë interesin e pagueshëm mbi borxhet e marra për qëllime të kapitalit të punës, të përlogaritur me metodën e normës efektive të interesit.

d) Te ardhura nga Demi ekonomik

4.12 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktive dhe detyrime për qëllime tatimore.

Gjendet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivët tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.13 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shendetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.14 Aktivët dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.15 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

5. VLERËSIMI I DREJTIMIT PËR VIJIMËSINË E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e Shoqërisë do të ketë vijimësi, në përputhje me përshkrimet e zbatimit të këtij parimi në Standartin Kombëtar të Kontabilitetit (SKK) Nr.1 Paragrafi 46-47. Siguria në vijimësinë e aktivitetit të shoqërisë në vitin 2021 dhe në vazhdim mbështetet në:

a. Pozita e favorshme në tregun e energjisë

Shoqëria vazhdon të ruajë pozitë monopol në tregun e shpërndarjes së energjisë, pozitë e cila për periudhën në vazhdim sanksionohet edhe në ligjin Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë" datë 30.04.2015 i cili parashikon vazhdimin e aktivitetit të Shoqërisë aksionet e të cilët zotërohen tërësisht nga shteti dhe për të cilin nuk ka plane afatshkurtëra dhe afatmesme privatizimi.

Ndarja e aktivitetit të shpërndarjes nga aktiviteti i shitjes së energjisë bazuar në kërkesat e ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjisë" dhe funksionimi i plotë i Shoqërisë si një shoqëri që ushtron aktivitet të pavarur të licencuar nga ERE prej datës 01.01.2020 ndryshoi tërësisht mënyrën e administrimit të Shoqërisë si një shoqëri që merr vendime manaxhuese dhe siguron të ardhura për aktivitetin e saj në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të pavarur.

b. Mbështetja e qeverisë

Qeveria i ka kushtuar vëmendje të veçantë sektorit energjistik duke nxjerrë akte dhe angazhuar strukturat qeverisëse për stabilitetin e sektorit dhe përmirësimin e treguesve të shoqërive shtetërore që operojnë në këtë sektor, ku aktiviteti i shpërndarjes së energjisë që mbulohet nga Shoqëria për vetë pozitën dhe problematikën e trashëguara ka marrë një vëmendje kryesore:

1. Në korrik 2017, Qeveria ka miratuar "Strategjinë kombëtare të energjisë" për periudhën 2018-2030. Kjo Strategji përcakton objektivat strategjike për të: i) zbutur rreziqet që lidhen me rritjen e kërkesës, cilësinë e shërbimit etj. dhe ii) cilësinë e furnizimit duke promovuar burimet e rinovueshme të energjisë, efikasitetin energjistik dhe bashkëpunimin rajonal. Këto parime udhëzuese përcaktojnë bazat për arritjen e këtyre objektivave strategjike.

Strategjia përcakton masat kryesore të kërkuara nga pjesëmarrësit e sektorit që ndër të tjera për shoqërinë OSSH (si pjesë e OSHEE Grup) theksojnë:

- vazhdimësinë e investimeve për të ulur më tej humbjet e shpërndarjes;
- përgatitjen e rregullave lidhur me sigurinë dhe lidhjet e rrjetit, cilësinë e furnizimit;
- planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për një periudhë 5-vjeçare së bashku me mjetet e monitorimit dhe tarifën vjetore të kërkuar;
- zbatimin e ndarjes së aktiviteteve të shpërndarjes;
- zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve.

Treguesit e Monitorimit janë :

- Reduktimi i humbjeve joteknike të shpërndarjes të energjisë elektrike, që llogaritet si raport i humbjeve joteknike (që nuk faturohen) në rrjetin shpërndarës përkundërt energjisë elektrike që futet në rrjetin shpërndarës;
- Reduktimi i humbjeve teknike të shpërndarjes të energjisë elektrike që llogaritet si raport i humbjeve teknike në rrjetin shpërndarës përkundërt energjisë elektrike që futet në rrjetin shpërndarës;

5. VLERËSIMI I DREJTIMIT PËR VUIMËSINË E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË (VAZHDIM)

Këto objektiva dhe masat për realizimin e tyre, tregojnë angazhimin e qeverisë për sektorin energjetik në përgjithësi dhe për Shoqërinë në veçanti, për të përmirësuar treguesit ekonomiko-financiarë në të ardhmen.

1. Në mbështetje të kësaj strategjie me VKM Nr. 253 datë 24.04.2019 "Për miratimin e Planit të Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik, Elektroenergjetik" në vazhdim të Planit të Rmëkëmbjes për të arritur objektivat e sipërpërmendura Qeveria propozon:

- Kontrollin e kujdesshëm të të gjitha shpenzimeve të ardhshme kapitale për të kursyer paratë;
 - Zbatimin e skemës së ristrukturimit financiar dhe fiskal në kompanitë e sektorit publik të sektorit të elektroenergjetik;
 - Përmirësimin e një kornize rregullatore për promovimin e një metodologjie të shëndoshë për caktimin e tarifave për të përmbushur të ardhurat e kërkuara të aktiviteteve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe promovimin e masave për liberalizimin e tregut; dhe
 - Përqendrimin në veprime specifike të konsolidimit financiar për të rritur performancën e kompanive të sektorit dhe për të përmirësuar likuiditetin e sektorit, për të reduktuar në mënyrë progresive kapitalin negativ në periudhën afatmesme si dhe për të zvogëluar ndikimin e përdorimit të tepër të borxhit për të financuar aktivitet shtesë (leva financiare).
2. Në fund të vitit 2021 Qeveria e Shqipërisë morri masa të menjëhershme lidhur me rritjen e jashtëzakonshme e çmimeve në tregun e parregulluar. Me të Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 8.10.2021 "Për shpalljen e gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike" Shoqëria pezulloi të gjitha planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Planet për investime nuk u pezulluan vetëm për ato që lidheshin me sigurimin normal të furnizimit si lidhje dhe linja të reja, mirëmbajtje si dhe për investime të veçanta në zona me interes të veçantë për ekonominë e vendit si ato turistike (Himarë).

c. Rezultati ekonomik i aktivitetit dhe përmirësimi i pozicionit financiar të OSSH

Rezultati financiar i shoqërisë për vitin 2021 është me humbje prej 3,677 milion Lekë. Tarifat e shërbimit të shpërndarjes, penalitete të faturuara nga KESH për pagesa të prapambetura të energjisë të periudhave të mëparshme si dhe shpenzime përmbartimore për vendime gjyqësore ishin shkaqet kryesore të mungesës së performancës së OSSH për vitin 2021.

Tarifa e ulët e shpërndarjes, rritja e çmimit të energjisë në tregun e lirë si edhe rritja e sasisë së energjisë të shpërndarë në rrjetin e OSSH në krahasim me vitin 2020 ishin faktorët kryesorë të humbjes financiare. ERE nuk mori parasysh aplikimin për tarifa dhe çmime të OSSH për vitin 2021 dhe nuk mori asnjë vendim duke lënë në fuqi tarifën dhe çmimet e mëparshme. Kostot e përfshira si element i llogaritjes së tarifave të shpërndarjes ishin dukshëm më të larta se ato të vendosura nga ERE dhe të pandryshuara prej vitit 2015, ndërkohë propozimi për rritje të tarifave të shpërndarjes nuk kërkonte ndryshim të çmimit të shitjes për klientët fundorë, por vetëm rishpërndarje të të ardhurave të kërkuara brenda OSHEE Grup duke rritur të ardhurat e OSSH duke i ulur ato të FSHU.

OSSH (si pjesë e OSHEE Grup) ka shlyer të gjitha detyrimet vjetore sipas planeve të aprovuara dhe marrvëshjeve të lidhura për ristrukturimin e pagesave të prapambetura ndaj KESH dhe OST. Përfunduar faktorët e sipërpërmendur shoqëria përgjithësisht arriti parashikimet në programin ekonomik të vitit nëpërmjet masave të marra në përmirësimin e treguesve ekonomiko-financiarë të cilët mundësuan:

- Zvogëlim i humbjeve jo-teknike nëpërmjet forcimit të kontroleve në rrjet, ndërprerjes së lidhjeve të paligjshme dhe vendosjes para ligjit të abuzuesve si dhe nëpërmjet investimeve që përmirësojnë teknologjinë dhe organizimin e punës.
- Zvogëlimin e humbjeve teknike nëpërmjet rritjes së efikasitetit të rrjetit nga përmirësimi i mirëmbajtjes dhe investimeve të reja.
- Rritjes së efikasitetit të punës së punonjësve të shoqërisë nëpërmjet masave organizative, rritjes së kualifikimit dhe motivimit të punonjësve.

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

5. VLERËSIMI I DREJTIMIT PËR VUIMËSINË E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË (VAZHDIM)

- Përmirësimi të cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet investimeve në teknologji të përparuara që përmirësojnë treguesit teknikë të furnizimit.
- Zvogëlimi të kohës së ndërprerjeve teknologjike dhe të kohëzgjatjes së riparimit të defekteve në rrjet.

Më poshtë treguesit kryesorë të performancës periudhës 2021 – 2022 në milion Lek :

	<u>2021</u>	<u>2022</u>
Marzhi bruto	12,364	17,526
Të ardhura të tjera	3	16
OPEX pa përfshirë amortizimin	(11,965)	(8,012)
Provgjionim edhe rezerva	1,890	(1,403)
EBITDA	403	8,128
Fitim Neto	(3,677)	3,788
	<u>2021</u>	<u>2022</u>
Norma e humbjeve	20.62%	19.72%
Tarifa e OST (Lekë/kwh)	750	0.85

Masa të tjera

Përmirësimi i punës në drejtim të forcimit të njësive të reja organizative të shoqërisë OSSH, përkundrejt vazhdimi të përmirësimit të treguesve ekonomiko – financiarë është një proces që po zhvillohet nën këshillimin e konsulences dhe eksperiencës më të mire të huaj, nën vëzhgimin e ndjekjen hap pas hapi në mënyrë të drejtëpërdrejtë të Qeverisë Shqiptare. E ndodhur në kushte të vështirësive të likuiditetit për shkak të rritjes së jashtëzakonshme të çmimeve OSSH ngadalësoi ritmin e investimeve të planifikuara gjatë vitit 2021 në zbatim të VKM 584, datë 8.10.2021.

Për shoqërinë, synohet të përmirësojë pozicionin e saj financiar në mënyrë që të jetë në gjendje jo vetëm të përmbushë në mënyrë korrekte dhe efikase rolin e saj si shpërndarës i vetëm i energjisë në Shqipëri, por gjithashtu t'i paguajë borxhet e saj ndaj KESH- it dhe OST-së si dhe detyrimet tatimore. Qeveria është plotësisht e angazhuar për të përmirësuar efikasitetin, kapacitetin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare nëpërmjet reduktimit të mëtejshëm të humbjeve duke përsheptuar zbatimin e Projektit të Konsolidimit Financiar. Përmirësimi i punës tekniko-organizative dhe investimet e kryera ulën mesatarisht prej 2.45 % në vit humbjet e energjisë në rrjet nga 37.8% në fund të vitit 2014 në 20.62% në vitin 2021.

Në përfundim:

Vijimësia e aktivitetit të Shoqërisë në kushtet e operatorit të vetëm të shpërndarjes së energjisë elektrike por edhe bazuar në ecurinë e përmirësimit të treguesve kryesorë të aktivitetit, në masat e marra nga Administrimi e në veçanti nga Qeveria, garantojnë vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë.

Operatori i Sistemit të Shperndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë paraqitur si mëposhtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Aktive te qendrueshme te trupezuara	55,402,791	42,955,167
Investime në proces	7,801,507	12,681,074
	63,204,298	55,636,241

Investime në proces më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë detajuar si mëposhtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Çelje 1 Janar 2021	12,681,074	-
Transferim i vleres së aktiveve të trupëzuara në proces nga OSHEE	-	10,416,387
Shtesa	15,793,091	4,075,081
Pakësime	(20,672,658)	(1,810,394)
	7,801,507	12,681,074

Shoqëria ka realizuar me të tretë inventarizimin dhe rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, që i përkasin balancave më 31 dhjetor 2019. Identifikimi fizik dhe krijimi i regjistrit të ri, krahasimi me kontabilitetin dhe nxjerrja e diferencave, ka qenë një proces që ka marrë një kohë relativisht të gjatë, ku ndikuan jo vetëm pandemia Covid-19 por edhe shtrirja në gjithë teritorin e vendit e ngarkesa e madhe e punës për të evidentuar e saktësuar të dhënat për 327 mijë aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale të katër shoqërive të Grupit. Procesi i inventarizimit ka filluar në fillim të vitit 2019 dhe identifikimi në terren e rivlerësimi i tyre ka përfunduar në fund të vitit 2021. Është bërë krahasimi me kontabilitetin dhe kanë rezultuar vlera relativisht të mëdha të difencave plus dhe minus. Treguesit e procesit, janë miratuar nga Këshilli Mbikqyrës në Mars 2022. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, me miratimin e rezultateve, në prill të vitit 2022, vendosi që të ndiqen procedurat e nevojshme për sistemimin e diferencave dhe identifikimin e përgjegjësi në përfundim të procesit. Pas angazhimit të specialistëve me grupe pune nga shoqëritë e Grupit, u mundësua identifikimi i shumicës së aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale dhe rezultoi diferencë nga inventarizimi, duke u ju referuar saktësimit të përshkrimit, të dhënave teknike e informacioneve të tjera nga historiku i kapitalizimit të tyre. Gjatë këtij procesi, u bënë kompensimet përkatëse ndërmjet shtesave dhe mungesave, duke rezultuar në përfundim tregues shumë më të përmirësuar se në fillim.

Rezultatet e treguesve përfundimtare të procesit të inventarizimit dhe rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, nga saktësimet dhe kompensimet, janë miratuar nga Këshilli Mbikqyrës në fund të dhjetorit të vitit 2022 dhe saktësuar gabimin material me vendimin në fillim të muajit korrik të vitit 2023. Ky vendim është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë në shtator të vitit 2023. Implementimi në kontabilitet i treguesve të inventarizimit dhe rivlerësimit të të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, ka vazhduar gjatë vitit 2023 duke përgatitur informacionin e duhur sipas kërkesave të SAP dhe duke bërë testimet e nevojshme për të verifikuar pasqyrimin e vlerave në llogaritë përkatëse. Në shtator është bërë hedhja e të dhënave përfundimtare të treguesve në SAP, sipas shoqërive të Grupit duke rezultuar implemtim i saktë sipas treguesve të miratuar.

Treguesit :

	000/leke
a. Shtesë në llogaritë e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale	8,082,953
b. Shtesë në llogarinë "Debitor"	995,447
c. Shtesë në llogaritë e kapitalit	9,079,032
i. shtesë e rezervës së rivlerësimit	24,965,479
ii. Paksim i Fitim-humbje të mbartura	(15,886,447)

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbylltur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Aktivitet e qendrueshme te trupezuata më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë detajuar si mëposhtë:

	Rikonstrukcione		Makinieri e	Te tjera	Total
	Toka	Ndertesa	Pajisje		
Çelje me 1 Janar 2021	1,834,419	2,630,062	42,899,017	935,021	48,298,519
Transferim i vleres se AAM nga OSHEE	-	-	-	-	-
Korrigjim i vleres bruto	-	-	-	-	-
Korrigjim i vleres me amortizimin e akumuluar per AAM e rivleresuara me vlere te mbetur 01.01.2021	-	-	-	-	-
Rivleresime					
Rivleresim ne rritje nga inventari fizik	-	-	-	-	-
Rivleresim ne rënie nga inventari fizik	-	-	-	-	-
Shtesat					
Shtesa nga inventari fizik	-	-	-	-	-
Shtesa të vitit	114	982,757	14,385,953	392,766	15,761,590
Transferuar nga FSHU	-	-	-	-	-
Pakesime					
Mungesa te inventari fizik	-	-	-	-	-
Korrigjim i vleres per AAM e kompesuara ne grup	-	-	-	-	-
Transferuar ne FSHU	-	-	-	-	-
Riklasifikime					
Gjendje 31.12.2021	1,834,533	3,612,819	57,284,970	1,327,787	64,060,109
Amortizimi Akumuluar çelje me 1 Janar 2021					
Transferim i vlerës nga OSHEE	-	(268,642)	(4,763,237)	(311,473)	(5,343,352)
Korrigjim i vleres per AAM e rivleresuara	-	-	-	-	-
Korrigjim i vleres per AAM e rivleresuara me vlere te mbetur 01.01.2021	-	-	-	-	-
Shtesa					
Amortizimi vjetor	-	(270,275)	(2,840,123)	(203,568)	(3,313,966)
Amortizim i AAM të ardhura nga FSHU	-	-	-	-	-
Pakesimi					
Amortizimi akumuluar i AAM mungese	-	-	-	-	-
Amortizim i AAM te transferuara ne FSHU	-	-	-	-	-
Korrigjim AAM te kompesuar ne grup	-	-	-	-	-
Riklasifikimi					
Amortizimi Akumuluar gjendje me 31.12.2021	-	(538,917)	(7,603,360)	(515,041)	(8,657,318)
Vlera Neto 31.12.2021	1,834,533	3,073,902	49,681,610	812,746	55,402,791

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbylltur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumatat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Kosto	Toka	Rikonstrukcione Ndertesa	Makinieri e Pajisje	Të Tjera	Asete në proçes	Total
Gjendja më 1 janar 2019	-	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Transferim i vlerës AQT nga OSHEE	1,064,968	4,605,461	46,773,142	1,853,820	10,416,387	64,713,778
Korrigjim i vlerës historike me amortizimin per AQT e rivlerësuar	-	(441,760)	(10,787,911)	(706,531)	0	(11,936,202)
Rivlerësim						
Rivlerësim në ritje nga inventari	817,341	620,437	24,187,718	198,216	-	25,823,712
Rivlerësim në rritje nga inventari	(506,171)	(2,089,931)	(15,968,837)	(159,798)	-	(18,724,737)
Shtesa						
Shtesat nga inventari	527,441	748,900	790,901	73,719	-	2,140,961
Shtesat viti	-	109,655	1,363,892	217,081	4,075,081	5,765,709
Transferuar nga FSHU	12	750	-	69	-	831
Pakësime						
Pakësime -Mungesa në inventar	(69,172)	(909,416)	(306,665)	(541,438)	-	(1,826,691)
Korrigjim i vlerës per AQT e kompensuar	-	(416)	(3,153,223)	(117)	-	(3,153,756)
Pakësime	-	-	-	-	(1,810,394)	(1,810,394)
Pakësime Transferuar FSHU	-	(13,618)	-	-	-	(13,618)
Gjendje 31.12.2020	1,834,419	2,630,062	42,899,017	935,021	12,681,074	60,979,593
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2019	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	-	-	-	-
Pakësime						
Transferim i amortizimit të akumuluar nga OSHEE	-	-	-	-	-	-
Korrigjim i vlerës historike me amortizimin per asetet e rivlerësuar	-	(591,586)	(16,060,794)	(1,325,789)	-	(17,978,169)
Amortizimi i vitit	-	441,760	10,787,911	706,531	-	11,936,202
Amortizimi i AQT të ardhura nga FSHU	-	(250,899)	(2,760,171)	(185,389)	-	(3,196,459)
Pakësime						
Amortizimi i akumuluar i aseteve mungese	-	130,912	116,594	493,124	-	740,630
Amortizimi i aseteve transf ne Fshu	-	1,238	-	-	-	1,238
Korrigjim i amortizimit të akumuluar asete kompesim grup	-	416	3,153,223	117	-	3,153,756
Riklasifikime	-	-	0	0	-	-
Gjendje 31.12.2020	-	(268,642)	(4,763,237)	(311,473)	-	(5,343,352)
Vlera neto kontabel më 31.12.2020	1,834,419	2,361,420	38,135,780	623,548	12,681,074	55,636,241

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, Shoqëria ka aktive afatgjata materiale të lënë peng si kolaterale tek Credins bank për pasuri të patundshme truall dhe ndertesa si dhe llogari të arkëtueshme.

Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr 20 dt 07.12.2020 "Mbi miratimin e marrveshjes së ndarjes së Shoqërisë Oshee Group sha" nëpërmjet transferimit të aktivitetit ndërmjet shoqërisë transferuese Oshee sha dhe shoqërisë pritëse Ossh sha është kryer transferimi i aktivitetit midis të cilave peshe të konsiderueshme zënë aktivet.

Rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale u bë duke përdorur regjistrimet bazë ekzistuese të Shoqërisë. Supozimet janë bazuar në të dhënat e marra nga Shoqëria, duke përfshirë edhe aktivet për të cilat titujt e pronësive nuk janë marre ende, dhe pa bërë inventarizimin e aktiveve afatgjata.

7. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Lëvizjet e aktiveve afatgjata jomateriale për vitin 2021 janë si më poshtë:

	Markat Tregëtare dhe Licencat	AQ të Patrupezuara në proces	Total 31.12.2021
Çelje 1 Janar 2021	278,383	161,498	439,881
Transferim i vlerës së AJM nga OSHEE	-	-	-
Korigjim i vlerës bruto në çelje	-	-	-
Korigjim i vlerës me amortizimin e akumuluar për AJM e rivlerësuara me vlerë të mbetur 01.01.2021	-	-	-
Rivlerësim	-	-	-
Rivlerësim në rritje nga inventari fizik	-	-	-
Rivlerësim në rënie nga inventari fizik	-	-	-
Shtesa	-	172,135	172,135
Shtesa nga inventar fizik	-	-	-
Shtesa të vitit	330,862	-	330,862
Pakesime	-	(259,518)	(259,518)
Mungesa të inventarit fizik	-	-	-
Gjendje 31.12.2021	609,245	74,115	683,360
Amortizimi Akumuluar çelje me 1 Janar 2021	(48,193)	-	(48,193)
Transferim i amortizimit të akumuluar të aktiveve të patrupezuara nga OSHEE	-	-	-
Korigjim i amortizimit në çelje	-	-	-
Korigjim i amortizimit në çelje për rivlerësim me vlerë të mbetur 01.01.2021	-	-	-
Shtesa	-	-	-
Amortizimi vjetor	(70,526)	-	(70,526)
Pakesime	-	-	-
Amortizimi akumuluar i mungesave	-	-	-
Amortizimi Akumuluar Gjendje me 31.12.2021	(118,719)	-	(118,719)
Vlera Neto	490,526	74,115	564,641

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

7. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

	Markat Tregetare dhe Licencat	AQ të Patrupëzuara në proçes	Total
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2019	-	-	-
Shtesat	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Transferim i vleres AQJT nga OSHEE	556,409	51,932	608,341
Korrigjim i vleres historike me amortizimin e akumuluar	(253,292)	-	(253,292)
Rivleresime			
Rivleresim ne ritje nga inventari	31,860	-	31,860
Rivleresim ne renie nga inventari	(76,492)	-	(76,492)
Shtesa			
Shtesa nga inventari Fizik	-	-	-
Shtesa te vitit	49,920	141,086	191,006
Pakesime	-	(31,250)	(31,250)
Mungesa te inventarit fizik	(30,022)	-	(30,022)
Gjendje 31.12.2020	278,383	161,498	439,881
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2019	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	-
Gjendje 31.12.2019	-	-	-
Transfrim i amortizimit te akumuluar nga OSHEE	(271,399)	-	(271,399)
Korrigjim i amortizimit ne celje per rivleresim	253,292	-	253,292
Shtesa			
Amortizimi vjetor 202	(45,921)	-	(45,921)
Pakesime			
Amortizimi akumuluar i aseteve mungese	15,835	-	15,835
Gjendje 31.12.2020	(48,193)	-	(48,193)
Vlera neto kontabël më 31.12.2020	230,190	161,498	391,688

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

8. AKTIVET NË PËRDORIM

Lëvizjet e aktiveve në përdorim për vitin 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

	Aktive në përdorim	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2021	286,447	286,447
Shtesa	782,127	782,127
Pakësime	(113,406)	(113,406)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	955,168	955,168
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2021	123,916	123,916
Amortizimi i vitit	332,736	332,736
Kthim amortizimi	(113,366)	(113,366)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	343,286	343,286
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	162,531	162,531
Gjendja neto më 31 dhjetor 2021	611,882	611,882

	Aktive në përdorim	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2020	-	-
Shtesa	286,447	286,447
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	286,447	286,447
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2020	-	-
Amortizimi i vitit	(123,916)	(123,916)
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(123,916)	(123,916)
Gjendja neto më 31 dhjetor 2019	-	-
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	162,531	162,531

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021

